

MOKRA NE ZGJEDHJET E 23 QERSHORIT, SI PJESE E PREFEKTURES SE KORÇES

# Hapet Tuneli i Elbasanit. Tani Mokra një orë më afër

Nga dita e dielë, shqiptarët do të kenë mundësi që ta përshkojnë segmentin që lidh kryeqytetin me Elbasanin, vetëm në 31 kilometër rrugë, duke shkurtuar kohën me 50 minu-ta, pasi përfundojnë punimet për ndërtimin e Tunelit të Ibës, pjesë e autostradës Tiranë-Elbasan. Ndërtimi i tunelit të Ibës, në autostradën Tiranë-Elbasan, filloi në 29 prill të viti 2011. Autostrada Tiranë-Elbasan përbën, pas Rrugës së Kombit, veprën e dytë më të madhe publike që ndërtohet në historinë e kombit shqiptar. Realizimin e një ëndrrë të shumë gjeneratave e ka konsideruar Kryeministri Sali Berisha hapjen e tunelit të Krrabës dhe bashkë me të autostradën Tiranë-Elbasan që shkurtton në 20 minuta distancën mes dy qyteteve. Kryeministri tha se 16 qershori, dita e përvitshmërisë të kësaj veprë, do të mbetet në memorien tonë si një ditë e krenarisë individuale e kombëtare. "Vendi që vetëm 6 vite më parë kishte rrjetin rrugor më të shkatërruar dhe prapambetur, po çan mallet, po ndërton tunele, kryevepra inxhinierike, po krijon realitete të reja gjeografike, ekonomike dhe sociale", tha Berisha, i cili e konsideroi autostradën Tiranë - Elbasan si segmentin më të rëndësishëm të Koridorit Tetë dhe Koridorit të Jugut.



## Speciale/Ja projekt - rruga "Qukës – Qafë Plloçë" që do realizohet në 2014

INTERVISTË ME ZOTIN KOÇO PIQONI, KANDIDAT I PARTISË DEMOKRATE PËR INTEGRIM E PROSPERITET ("P. D. I. P") PËR QARKUN E KORÇES

**RILINDJE**  
23 QERSHOR DITA E NDORYSHIMIT

**"Do jem një portë e hapur për të trokitur e zgjidhur problemin tuaj!"**

**VOTO nr. 28**

INTERVISTË ME Z. ILIR XHAKOLLI, KANDIDAT PER DEPUTET

## Pas 23 Qershorit, edhe Mokra do të rilindë!



**HOMAZH PËR NËNË ALIJE FERON**

**HAMIT E HALIT HALLIDRI, NJË JETË KUSHTUAR ATDHEUT**

**AVNI GJONA, PARTIZANIN QË E NDOQI PAS HIJA E KOMUNIZMIT**

**OHRI, qyteti i dritës**



INTERVISTË ME KANDIDATIN PËR DEPUTET TË PS TË QARKUT KORÇË, ZOTIN ILIR XHAKOLLI

# Edhe Mokra do të rilindë, pas 23 Qershorit

I lindur dhe banues në qytetin e Pogradecit Ilir Xhakolli ka kryer Universitetin e Tiranës dhe është diplomuar më vitin 1987 për Ekonomi - Financë. Mbas kryerjes së studimeve është emëruar e ka punuar si ekonomist për disa vjet në Komitetin Ekzekutiv, në Ndërmarrjen Tregtare dhe në Drejtorinë e Doganave. Nga viti 2005 është marrë me aktivitetin biznesi. Aktualisht është kandidat për deputet në listën e PS për Qarkun e Korçës dhe me siguri do të jetë deputeti i ardhshëm në Parlamentin e Shqipërisë.

**Z. Ilir, cili është kontributi juaj në Partinë Socialiste?**

- Jam anëtar i hershëm me testë e me zëmër në Partinë Socialiste. Në vitin 2010 jam zgjedhur Kryetar i P. Socialiste i rrethit Pogradec, funksion që e kam dhe e mbaj edhe sot.

**- Cilat janë disa nga aritjet e Partisë Socialiste, gjatë këtyre tre viteve, nën drejtimin tuaj?**

- Fillimisht gjendja dhe treguesit e punës nuk ishin pozitive mbasi nga tetë njësi të pushtetit vendor që ka rrethi ynë, 7 komuna e Bashkinë e Qytetit, Partia Socialiste administron vetëm Bashkinë e Qytetit, ndërsa dy komuna L.S.I dhe pesë komuna të tjera administroheshin nga Partia Demokratike.

Në zgjedhjet për pushtetin vendor të vitit 2011 PS fitoi 6 gjashtë njësi vendore: Bashkinë e 5 Komuna, 2 komuna LSI, ndërsa PD, doli zero. Ajo mori ndëshkimin e merituar nga vota e popullit, si protestë e revoltë për keqqeverisjen e mbrapshtë, korrupsionin, mitmarrjen, drejtimin klanor e nepotik, duke e denigruar dhe identifikuar këtë forcë politike tashmë si një subjekt politik antipopullor. Mjafton të vlerësohen dëmtimet, prerjet e shfarosja e pyjeve, vënia edhe zjarret masive, prej mijëra e mijëra 27000 ha të tjera pyjesh. Pyjet shekullore të Valamarës, kësaj perle të natyrës e kësaj pasurie Kombëtare, thuajse janë zhdukur tërësisht. Krim ky që pret të gjykohet e të ndëshkohet personat përgjegjës, me krye Fatmir Mediu, i cili, me pafytyrësi, guxon të kandidojë edhe në qarkun e Korçës. Mbase si provokator e shëmbëlltë e kësaj qeverie.

Vlera monetare e shkakuar dhe më pas e vjedhur nga një mafie e mirëorganizuar shtetërore, korrupsion ky i lidhur dhe i denoncuar si çështje edhe nga organet e shtypi në organet e Prokurorisë vendore edhe Prokurorinë e Përgjithshme, me të paditur realë me emër e mbiemër deputetë e qeveritarë të inkriminua, vetëm ky fakt do mjaftonin e do tepron për të bërë dy e tre rrugë si ai aksi rrugor i munguar Qukës - Qafë Plloçë e dhjetëra vepra të tjera, mungesa e të cilave ka bërë që krahinë e Mokrës të braktiset e ç'popullohet.

Mendoj se ky fitorja në zgjedhjet e pushtetit vendor të 2011 është tregues kryesor i punës së PS në kolegjalitet e me koherencë njerëzore, pa ko-

mpromis me cilin do e me çdo qejf mbetje. PS është bërë sot më e forte se kurrë, e gatshme të marrë përgjegjësi të mëdha për t'ia ndërruar faqen vendit e për ta rilindur e begatuar edhe Mokrën tonë me shumë histori, por dhe halle madhe.

**- Cila është pritsshmëria e juaj në këto zgjedhje?**

- Partia Socialiste po punon dhe është e bindur se 23 qershori do jetë një votë plebishitare në gjithë Shqipërinë dhe doemos në qarkun Korçës e rrethet e saj, ku Pogradeci, Mokra, Gora, e Rrëza do dëshmojnë me votën e gjithë secilit prej nesh, kërkesën e nevojën, domosdoshmërinë e rrotacionit për Ndryshim dhe Rilindje e Shqipërisë.

**- Zoti Xhakolli, cili është programi i PS dhe vizioni juaj për ndryshimin e kësaj gjendje të rënduar, edhe të Mokrës, mbas 23 qershorit?**

Në programin e PS, bujqësia do ketë subvencione të mëdha për ta ndryshuar gjendjen. Bujqësia dhe Blegtoaria si dhe Pyjet do jenë strategji zhvillimi afatgjatë qeverisëse, si faktor i domosdoshëm, për sigurimin e përmirësimi e ushqimit të popullit, duke mundësuar vende punësimi pafund, faktor bazë për zhvillim e mirëqenie reale të popullit.

Votuesit duhet të kenë besim të plotë tek Programi i PS dhe të sigurt se nuk do ndje-



heni kurë të braktisur.

PS në programin e saj, gjatë 2 viteve të parë do rehabilitohen e vihen në funksion të plotë të gjitha veprat ujitëse, deri në nivelin e kanaleve dytësorë në të gjitha fshatrat e rrethit tonë dhe në të gjithë vendin.

\* Brenda mandatit katërvjeçar do përfundojë infrastruktura rrugore, si aksi rrugor Qukës - Qafë Plloçë dhe lidhja e të gjithë fshatrave me qendrat e komunave, si dhe katra-hurën e segmentit rrugor Lin - Pogradec.

\* Arsimi do njohë zhvillime cilësore, përparësi e rëndësi do marrë arsimit mesëm profesional, i cili do përgatitë me mijëra specialistë për të gjithë sektorët e jetës në vend, ku rëndësi të veçantë do ketë përgatitja edhe e teknikëve agronomë, zooveterinerë, teknike pyjesh, mekanizatorë etj

\* Shërbimi shëndetësor do

të pësojë transformime të mëdha, duke mundësuar mjekimin e shërimin e cilit do qytetari të këtij vendi, pa pagesë edhe për atë që nuk ka të ardhura financiare për ta përballuar, duke rilindur një shtet me shëndetësi, sociale, human për të gjithë shtetasit e saj.

**- Cilat do jetë mbështetja e shtetit për lehtësimin e fermerëve e blegtorëve nga politika e programit qeverisës?**

- Mbështetja për fermerët do jetë e prekshme dhe reale. Do hiqet TVSh për makineritë e impiantet bujqësore e blegtorale, plehurat e imputet bujqësore, 1 kv nitrat, nga 6000 lek do shitet 4000 lek, 1 kv Dap 7000 lek do shitet 4500 lek, 1 litër naftë për fermerët do tregtohet nga 190 lek do shitet 130 lek do përjashtohen nga tatimi e taksat i gjithë biznesi i vogël dhe shteti do kontrakttojë e

lidhë marrëveshje me OBT (Organizatën Botërore të Tregëtisë) për të siguruar tregje në tregun e BE e më gjerë, për prodhimet bujqësore e blegtorale, shumë cilësorë, sipas andarteve dhe me çmime shumë më të favorshme.

**- Zoti Ilir, cili është mesazhi juaj për votuesit dhe lexuesit e shumët të shoqatës "Pelioni" e gazetës atdhetare kulturore "Mokra"?**

Së pari, dua t'i përhëndes e t'i uroj që të kenë shëndet në familjet e tyre dhe dëshiroj t'i siguroj ata, se me besimin e palëkundur në fitoren e 23 qershorit nga "Koalicioni për Integrim Evropjan", nën udhëheqjen e Partisë Socialiste të Shqipërisë, do ta ndryshojmë e begatojmë jetën e të gjithë shqiptarëve me punë. Fitore! Ju Faleminderit!

Intervistoi korrespondenti i gazetës "Mokra", K.P

## POGRADEC- BODE: POLITIKAT SUBVENCIONUESE RRISIN PRODHIMIN BUJQESOR

Gjatë një mitingu elektoral në komunën Çërravë në Pogradec, kandidati i Partisë Demokratike për qarkun e Korçës, Fatbardh Kadilli, tha se kjo forcë politike ka zgjedhur për qarkun e Korçës kandidatë vendas, të cilët do të jenë më pranë interesave të çdo banori. Ndërsa ministri i Financave, sekretar i përgjithshëm i Partisë Demokratike, Ritvan Bode, që kryeson listën e kandidatëve për deputetë në qarkun e Korçës, tha se nga politikat subvencionuese dhe mbështetëse për bujqësinë 5500 fermerë kanë përfituar një shumë prej 650 milionë lekë. Kjo ka mundësuar, sipas tij, që rritja e prodhimit bujqësor të jetë më e larta e arritur historikisht. Bode i ka ftuar banorët e Çërravës dhe gjithë Shqipërisë që të mbështesin Partinë Demokratike më 23 qershor për të vijuar zhvillimin dhe integrimin e vendit. Duke i falenderuar banorët e komunës për mbështetjen e vazhdueshme që i kanë dhënë Partisë Demokratike, Bode tha se pas 23 qershorit zhvillimi i vendit do të jetë edhe më i vullshëm, edhe më i shpejtë, pasi Partia Demokratike do të vijojë të jetë pranë interesave të çdo banori e çdo familje.





INTERVISTË ME ZOTIN KOÇO PIQONI, KANDIDAT I PARTISË DEMOKRATE PËR INTEGRIM E PROSPERITET ("P. D. I. P") PËR QARKUN E KORÇËS

# "... Një portë e hapur për të trokitur e zgjidhur problemin tuaj!"

**K**oresp i "Mokrës" - Është kënaqësi të bëjmë bashkë këtë bisedë si vlerësim edhe për shoqatën "Pelioni" e gazetën Mokra ku juve jeni gazetar për shumë vite. Pyetja për ju: Cili është kandidati, zoti Koço Piqoni?

- Kam lindur në 12.04.1950 e jam banues në qytetin e Pogradecit, rrjedh nga një familje e nderuar qytetare e cila ka qënë e lidhur e pjesmarëse në LANCI dhe më pas kanë kontribuar në rindërtimin e ndërtimin e vëndit. Më pas si familje jemi përballur me persekucion e burgosje politike, sot jam pjesë e shoqatës së ish të përndjekurve me "Statusin e të Përndjekuri Politik"

I martuar me dy djem. Kam kryer I. L. B. Kamzë, fakultetin e Zoo - Veterinarisë.

Në Vitin 1976 e më pas kam ushtuar detyrën e specialistit të blektorisë në disa ekonomi bujqësore, në Dunicë të Mokrës, Blacë, Nd Shpendëve, D. R. Bujqësisë. Ins e Peshkimit. Tani specialist i sigurisë ushqimore pranë Bashkisë së Qytetit Pogradec.

**Koresp i "Mokrës" - Motivi i kandidimit tuaj?**

- Kam qënë i angazhuar në politikë nga viti 1991 dhe kam kontribuar me idealizëm qysh në fillimet e demokracisë duke kontribuar në ngritjen e Seksioneve të P. Demokratike në Nizhavec, Grabovicë, Dunicë dhe kam drejtuar për disa vite grup seksjonin e Lagjes Nr 4 Kala deri në vitin 1997.

Më pas jam ndjerë totalisht i zhgënjyer nga prania e shumë njerëzve pa integritet të katapultuar në këtë parti, prej së cilës jam distancuar e sot një bandë me duar të pista të cilët e kanë eliminuar demokracinë dhe e kanë fashistizuar e këthyer në një forcë të erët e cila duhet ndryshuar me votën e popullit në 23 qershor 2013

**Koresp i "Mokrës" - Me çfarë programi do garoni?**

- Logoja jonë është: "Shtet Ligjor i Vërtetë, Social e Demokratik."

Në programin politik të kësaj partie kërkohet: Reformim i thellë, marrje përgjegjësie në pranimin e kryerjen e detyrës, në mirëfunksionimin e tre pushteteve dhe institucioneve.

\* Rreformë në zgjedhjen e funksionimin e P. Legjislativ



**- VOTO PËR NJË SHQIPËRI MË TË MIRË**

**Po Ndryshimit**

**Jo Mashtrimit**

**Po Shpërblimit**

**Voto për kandidatin, bashkëqytetarin tuaj Për një turizëm vendor elitari**

**Voto zotit Kristaq Piqoni!**

**Për një shoqëri me ekuilibra ekologjike - politike - qytetarie.**

1- Kandidati për deputet të jetë bir a bijë e atij komuniteti

2- Fushatat zgjedhore të jenë bashkëkohore, me shpenzime modeste, kryesisht me përballje alternativash në median vizive e të shkruar, në ato qendrore e lokale, duke mundësuar shkurtimin e mijëra orëve të humbura pa efektivitet si mitingashë ti jepet fund kësaj praktike si reminishencë nga e kaluara, agjitacion, propogandë, intriga

3 - Votimi detyrim për shqiptarët e kudo ndodhur

4- Betimi i Deputetit të bëhet përpara Flamurit, Kushtetutës e Zotit.

5- Transferimi i pushtetit të deleguar nga vota i dënueshëm, të bëhet shkarkimi dhe zvendësimi i detyrueshëm.

6- Deputeti të jetë detyrimisht pjesë e pushtetit legjislativ vendor, K.P. Rretheve e Qarqeve, pjesmarës të detyruar në mbledhjet e tij si urë lidhëse e funksionimi i pushtetit vendor e atij qendror.

7- Kryetari i shtetit të mandatohet me votën direkt nga populli për të qënë pushtet real mbi palët e politikës

8- Kufizimi i mandatit të Kryetarit të Shtetit e Kryeministrit.

9 - K. Q. Z e K. V. Z të jenë pjesë e Gjyqësorit

10- Akademia e Shkencës të vlerësohet si truri elitari i kombit, hartuesi i strategjive për zhvillim kombëtar në të gjitha fushat e jetës së vëndit.

\* Sindikalizmi. Ti jepet fund ligjërimit të përcarjes e përdorimit të saj nga politika. Sindikatat të kryejnë misionin e tyre, të bëjnë opozitë reale me cilën çdo qeveri të radhës të jenë në mbrojtje të pasurisë publike e kombëtare, në mbrojtje të interesave të klasës puntore, përsigurimin e kushteve të mira pune, pagash, zbatimin e ligjeve, kontratave kolektive etj.

**Koresp i "Mokrës" - Aleatët, aleancat dhe alternati- vat e partisë tuaj?**

- Ne jemi për ndryshimin, kjo është dhe arsyeja që ndodhemi në këtë aleancë që udhëhiqet nga P. Socialiste Subjekt politik serioz i pozicionuar për politika sociale për masat e gjera të popullsisë, rimëkëmbjen e fshatit e të bujqësisë, blektorisë, pyjeve, peshkimit etj sektore jetikë për punësim, prodhim si mjet për zhdukjen e mjerimit.

**Koresp i "Mokrës" - Mendoni se do jeni pjesë e Kuvendit të ri të Shqipërisë?**

- Garimi im në këto zgjedhje ka për motiv dhenjen e një kontributi modest në maksimalizimin e votave nga votues indferent të pa vendosur dhe të djathtë të zhgënjyer e mashtruar nga kjo qeveri tashmë qartazi klanore, krahinore, servilash. Vlerësoj akt-marrëveshjen e Partisë Socialiste me partitë e vogla në të cilën konfirmohet shpërblimi sipas kontributit në vota e cila përkthehet në poste e vënde punësimi, gjë që mundëson që sipas numurit të votave të ofruara të vlerësohet dhe të shpërblehen. Konkretisht nqs:

Subjekti politik në një rreth a qark siguron

Për 5000 vota i ofrohet një post zv/Ministër

Për 3000 vota i afrohet nje post drejtor drejtorie

Për 500 - 1000 vota i ofrohet një drejtori në rretha qark

Për 100 vota një nënpunës i lartë në administratë

Për 50 vota një nënpunës me arsim të mesëm

Për 5-10 vota punësim në një punë në shtet a firmë.

Kjo ofertë është detyrimi i këtij subjekti ndaj votuesave të saj.

**Koresp i "Mokrës" - Cila është drejtorja që do dëshironi të drejtoni?**

- Mendoj Drejtorinë e Bujqësisë, Pyjores, a Zyrë punësimi. Mbasit në rrethe e qarkun ku subjekti do jetë në aleancë dhe me biznesin e bimëve medicinale, shoqatën e gjuetarëve, shoqatën e peshkimit, shoqatën e bletarëve, si dhe me mbarshuesat e gjedhit, të imtave etj.

**Koresp i "Mokrës" - Përse do votojnë për ju?**

- Eksperiencën, seriozitetin dhe besimin në mbajtjen e fjalës të bëra të njohura më lart. Edhe për qytetari, si një mundësi se do ketë nesër një portë të hapur për të trokitur e zgjidhur problemin tuaj.

**Koresp i "Mokrës" - Pas 23 qershorit si do të lëvizin marrëdhëniet me ne?**

- Do merrni ftesë për një drekë sipas traditës të barasvlefshme me një dasmë ku shpenzimi do llogaritet të jetë sa do jetë paga e parë, si shpërblim e mirënjohje e më pas për t'ju përveshur punës.

**Koresp i "Mokrës" : Si pjesë e stafit të gazetës "Mokra" uroj të dilni faqe bardhë në këtë angazhim politik. Ftoj antarët e degës të shoqatës të votojnë masivisht për ju, Nr 28.**

## BERISHA: MODELI YNË FRYMËZUES

- KRYEMINISTRI PËRURON AUTOSTRADËN TIRANË- ELBASAN-

**K**ryeministri Sali Berisha përuroi të dielën autostradën e re Tiranë-Elbasan, ndërsa u shpreh se "kjo ditë që do të mbetet në memorien tonë si ditë e krenarisë individuale, krenarisë sonë kombëtare".

"Ne, sot me 16 qershor 2013 bëjmë realitet një endërr tonën, një endërr jo vetëm të gjeneratës sonë, por të gjithë gjeneratave të cilat ëndërronin që një ditë që Elbasani, ky qytet i shpirtit dhe zemrës së bardhë shqiptare, djep i dijes dhe shkollimit, të bashkohej me Tiranën përmes një tuneli", tha Berisha.

Berisha e cilësoi autostradën "financim me ndjenja më miqësore". Ai falenderoi Bankën Islamike për Zhvillim, fondin Abudabi e të tjerë për realizimin e kësaj kryevepre.

"Sot, tuneli dhe autostrada sjellin Elbasanin pranë Tiranës si qytetin më të afërt, por edhe Librazhdin, Gramshin, Dumreja do të jenë në Tiranë për 35-40 minuta. Po ashtu Pogradeci, Korça, Kolonja afrohen me Tiranën", tha ai.

Duke e cilësuar autostradën Tiranë-Elbasan si një segment kryesor të Koridorit 8, Berisha vuri në dukje se "Shqipëria inauguron sot segmentin që do të sjellë flukse më të mëdha nga Lindja në Perëndim, ku porta në Ballkan është vendi ynë".

Ky segment, vijoi ai, është pjesë e rëndësishme edhe e Koridorit të Jugut, që sjell Beratin, Tepelenën në kohë rekord në Tiranë. Për rëndësinë që ka për zhvillimin e vëndit tuneli i Krrabës, Kryeministri e quajti atë "monumenti madhështor i një modeli që ka vetëm një qëllim: përmirësimin e jetesës së qytetarëve shqiptarë".

Sipas tij, përmes tunelit, tregu i madh i Tiranës dhe Elbasanit shkrihen në një. "Me të bëjmë që prodhimet e Elbasanit dhe Korçës të vijnë në tregun më të madh me kosto më të ulët dhe shpejtësi të madhe", tha Berisha, që reshtoi dhe avantazhe të tjera, ndër to edhe avantazhet për studentët, të cilët nuk do të kenë më nevojë të marrin baneza me qera për studimet universitare, etj.

Autostrada Tiranë-Elbasan që u përuroi ka një gjatësi prej 27 kilometra, 4 korsi, një tunel 2,5 kilometra të gjatë, 7 mbikalime, 21 vijadukthe dhe 4 nënkalime. Kjo autostradë përbëhet nga tre segmente: Segmenti I (Sauk - Tuneli i Krrabës, me gjatësi 13 km) Segmenti II (Tuneli i Krrabës me gjatësi 2.5 km) dhe Segmenti III (Tuneli i Krrabës - Elbasan, i gjatë 11.5 km). Tuneli i Autostradës u ndërtua në një kohë rekord, 13 muaj. Punimet për ndërtimin e tij nisën në maj 2011 dhe pas 9 muajsh, filluan dhe dy kontratat e tjera të segmenteve rrugore para dhe pas tunelit.

Autostrada Tiranë-Elbasan shkurtor ose u kursen së paku 40 minuta kohë dhe është rrugë kryesore drejt Tiranës për qytetarët e rretheve Elbasan, Librazhd, Korce, Pogradec, Kolonje. Ajo gjithashtu është pjesa e parë e Boshtit të Jugut. (Cerrik, Belsh, Kucove, Berat, Tepelenë, Gjirokastër, Delvinë, Sarandë).

Me ndërtimin e saj, skajet ekstreme jugore dhe lindore të Shqipërisë do të arrijnë në Tiranë për më pak se 2 orë me perfundimin e segmenteve, që vijnë pas autostradës.




# Projekt - Rruga "Qukës-

## KARAKTERISTIKAT E GJURMES SE RRUGES SE RE

Rruga e re mund të ndahet në disa pjesë.

Ne segmentin e pare, ndërmjet Km 0,0 dhe Km 10,5 rruga ndodhet ne nje zone te sheshte ndermjet kuotave

konsistente. Nga km 41.5, me lartesi 850m mbi nivelin e detit deri ne km 43.3, qe perfaqeson piken lidhese me segmentin e rehabilituar Qafe Plloce - Korce, gjurma rrit lartesine ngadale duke arritur ne fund me nje lartesi 875m mbi nivelin e detit.



440m dhe 550m mbi nivelin e detit, dhe shtrihet paralel me shtratin e lumit Shkumbin, mbi gjurmen e rruges ekzistuese i shtrire ne nje relief qe perbehet nga conglomerate dhe rere. Sh-tresa aluvionale eshte e perbere nga material zhavorri dhe rere.

Nga Km 10,5 në Km 15,9 rruga zhvillohet ne drejtimin V-J, duke ndjekur anen e majte te lumit Shkumbin. Gjerësia dhe thellësia e zonës aluvionale fillon të zvogelohet derisa ajo zhduket dhe lumi shkon vetë midis kodrave. E njejta gje mund te thuhet per gjurmen e rruges e cila ndjek anen e malit, qe shtrihet ne afersi te shtratit te lumit. Ky terren kodrinor është i përbërë nga flishi gëlqerore. Relievi ne kete zone dominohet nga fraksione litoidi sesa nga ato argjiloz.

Nga km 15, 9 me kuote rreth 580m, deri ne km 22.9 me kuote 1020m mbi nivelin e detit, gjurma e rruges dalengadale rritet ne kuote, duke u ngjitur kodrave perreth, ne formacione ranore te shpatit qe ndërthuren me formacione gëlqerore. Gjurma largohet nga rruga ekzistuese per te perfitur nje pjerrsi gatesore max 7%.

Midis km 23 dhe km 27 (me lartesi mbi nivelin e detit 1030 m), morfologjia zbutet kretjesisht. Ne kete zone ndodhen disa fshatra (Trebinja, Malina, Kalivaci). Ndersa gjurma ekzistuese kalon mes fshatrave, aksi i ri zhvillohet jashte tyre duke kaluar disa qindra metra larg zones se banuar.

Rreth km 28 gjurma e rruges rrit lartesine menjehere duke arritur kuoten max 1325 m, deri ne km 31,9 duke kaluar ne nje zone malore te demtuar, me shpate gerqerore dhe ranore. Pikerisht ne kete zone per te ruajtur pjeresite gjatesore eshte menduar nje tunel midis km 31.5 me gjatesi 375 ml. Pas km 32, gjurma ne drejtim te Qafe Plloces fillon zbrit ne kuote deri ne km 41.5, lartesia arrin (815m) mbi nivelin e ditit, ne afersi te fshatit Geshtenjas. Gjurma e re e vendosur ne mes te shpateve me formacion gëlqeror dhe ranor vecanerisht

## TRASHEGIMIA ARKEOLOGJIKE DHE KULTURORE

Burime arkeologjike jane percaktuar rrenojat e vjetra, reliket, produkte ekologjike ose depozitime tokesore me rendesi te vecante kulturore. Ne kete kapitull jane marre gjithashtu ne konsiderate ndertimet me interes historik dhe arkitekturor.

### 5.1.1. TRASHEGIMIA ARKEOLOGJIKE DHE KULTURORE

Monumentet e trashhegimise kulturore jane ne nje distance te mjaftueshme nga rruga e propozuar dhe per kete nuk kerkohet studim i vecante.

### 5.1.2. NDIKIMET NE TRASHEGIMINE ARKEOLOGJIKE DHE KULTURORE

Eshte shume evidente nga studimet se rruga e propozuar nuk do te kete asnje impakt te rendesishem ne terrenet historike kulturore apo arkeologjike per shkak te distances ndermjet rruges se propozuar dhe terrenet me interesit arkeologjik, Monumentet e trashhegimise kulturore jane ne nje distance te mjaftueshme nga rruga e propozuar dhe per kete nuk kerkohen masa te vecanta mbrojtjeje.

### 5.2. PEISAZHI DHE BUKURITE NATYRORE

Ky seksion pershkruan peisazhin egzistues qe perfshihet ne zonen ne studim, dhe ben nje vleresim te peisazhit dhe ndikimit vizual te skemes se propozuar, detajet dhe metodologjine e perdorur dhe propozon masa per te zbutur ndikimet negative.

Ky kapitull pershkruan metodologjine per vleresimin e efekteve ne karakterin e peisazhit, qe do te thote kombinimin e vecorive dhetributeve qe kontribojne ne karakterin e vecante dhe dallues te zonave te ndryshme.

### 5.2.1. BURIMET E INFORMACIONIT

Burimet e informacionit qe jane perdorur per te kryer vleresimin kryesore perfshijne:

Hartat e shfrytezimit te tokes; vizita te shpeshta ne kantier.

### 5.2.MJEDISI EKZISTUES

Ne zonen ku kalon ky segment rrugor kemi tre njesi gjeomorfologjike te medha njesia e pare eshte zona e lugines se lumit Shkumbin, njesia e dyte eshte zona e lugines se lumit te Dushes dhe njesia e trete jane kodrat e zones nga Prenjasi deri ne Plloce.

-Zona e lugines se lumit Shkumbin perfaqeson nje luginë me shpate te qeta por ne disa raste shpatet jane shume te pjerrta pjerrësia e shpateve varet nga perberia gjeologjike. Kjo luginë ne pjesen e pare ka disa teraca me permasa mesatare mbi te cilat jane ndertuar

fshatrat e zones ne keto teraca do te kaloje dhe aksi i rruges se projektuar. Shpatet e lugines se lumit Shkumbin jane te pyllezuara me bimesi te shkurtër. Ne disa pjese te lugines jane shume te zvuilluara fenomen negative fiziko gjeologjike si shembjet dhe rreshitjet e formacioneve mbulesore por dhe pjesa e perajruar e formacionit rrenjesor. Varianti i aprovuar i rruges se re ka marre parasysh keto fenomene deh aty ku ka patur mundesi eshte zgjedhur zona me e qendrueshme. Per zonat me qendrueshmeri te dobet eshte treguar nje kujdes i vecante per marrjen e masave inxhinierike per stabilizimin e shpateve dhe stabilizimin e rruges se re.

-Zona e lugines se lumit Dushes dhe perrejte kryesore nga km 15deri ne fund te projektit. perfaqesojne disa luginë me shpate te pjerrta por ne disa raste shpatet jane shume te pjerrta pjerrësia e shpateve varet nga perberia gjeologjike. Ne shpatet e ketyre luginave kane nje zhvillim intensiv fenomenet fiziko gjeologjike nga punimet ne terren sidomos ne zonen nga Goliku deri ne Potgozhan ka disa zona rreshqitjesh aktive. Shpatet e luginave jane te pyllezuara me bimesi te shkurter. Ne disa pjese te luginave jane ndertuar fshatrat e zones. Varianti i aprovuar i rruges se re ka marre parasysh keto fenomene deh aty ku ka patur mundesi eshte zgjedhur zona me e qendrueshme. Per zonat me qendrueshmeri te dobet eshte treguar nje kujdes i vecante per marrjen e masave inxhinierike per stabilizimin e shpateve dhe stabilizimin e

rruges se re.

-Kodrat e zones nga Prenjasi deri ne Qafe Plloce. Jane kodra me lartesi te vogel mbi te cilat jane ndertuar fshatrat e zones. Keto kodra ndertohen ndertohen nga shkembinj sedimentare qe jane depozitime copezore (argjilitet, alevrolitet, ranoret dhe konglomeratet). Formacionet terrigjene ose copezore jane formacione gjysem shkembore dhe formojne e shpate me pjerrsi te bute. Ne pjeset fundore te shpatit jane te mbjella me drunj frutore dhe ne disa raste dhe toka bujqesore. Nga studimi i kryer ne zonen e pare ne fshatin Qukes deri ne fshatin Golik predominojne shtresat e ranoreve me çimentim te mire te formojne shpate te qendrueshme kurse nga Goliku dei ne Plloce predominojne shtresat e argjiliteve dhe shpatet jane me probleme per stabilizimin e tyre. Ne çdo rast do te kryhen studime te detajuara per te vleresuar marrjen e masave inxhinierike optimale per stabilizimin e tyre. Shpatet e kodrave jane te pyllezuara me bimesi te shkurter por ne disa raste jane te mbjella me drunj frutore.

### BURIMET NATYRORE

#### 6.1. KLIMA

Klima i referohet si vecorive afatgjata te motit ne nje zone (makroklima) ashtu dhe kushte atmosferike lokale, apo mikroklima. Klima mund te kete ndikime te dallueshme mbi tipin e flores dhe faunes qe gjenden ne nje zone, si dhe ne praktikate e pergjithshme te perdorimit te tokes.

#### 6.1.2. GJENDJA EKZISTUES

Faktoret meteorologjike jane rrezatimi diellor, temperatura, presioni atmosferik, lageshtia, era. Rendesia e ketyre faktoreve qendron ne faktin se ata ndikojne drejtpersdrejti mbi perseritjen dhe ndryshueshmerine e reshjeve etj. Ecuria e njerit behet shkas per ndryshime te rendesishme tek tjetri.

Kendi i renies se rezeve te diellit ne zonen ne studim ndryshon pak. Pra zona eshte ne kushte te barabarta persa i perket energjise qe marrin nga dielli.

Numri i diteve me diell eshte nje tregues klimatik me interes praktik.

Ne table 2 jepet numri i

diteve me diell.

Ne muajt e veres, nuk ka asnje dite pa diell. Mund te permendim se dite me diell pranoohen ato dite gjate te cilave ne diagramen e eliografit vrojtohen djeje ose gjurme te saj te pakten ne nje pjese minimale qe i perket 6

minutshit.

Shqiperia, si vend mesdhetar, karakterizohet nga sasira te medha oresh me ndricim dielli. Sasira e oresh me ndricim dielli ndryshon ne menyre te theksuar nga njeri muaj ne tjetrin. Per sasine me te madhe te oresh me ndricim dielli dallohen muajt e stines se veres, kurse me pak ore kane muajt e dimrit.

### Era

Era percaktohet si levizje horizontale e ajrit, ndersa levizja vertikale qyhet rryme ajri. Karakteristikate kryesore te eres jane drejtimi dhe shpejtesia e eres. Drejtimi i eres eshte kahu nga fryn era dhe merr emrin e tij sipas nje prej 16 pikave te horizontit.

Lugina e lumit sherben si nje drejtues per rrymat ajrore dhe po te gjykojme nga te dhenat e stacionit meteorologjikm te Elbasanit drejtimi dominues, ne te gjithë stinet, jane VL (20% te rasteve) dhe JP (10.4% te rasteve)

Rrymat ajrore jane nje nder faktoret kryesore te formimit te klimes.

Ne territorin ne studim drejtimi i eres gjate vitit eshte i ndryshueshem.

Ne tabelen 3 jepet rastsija (ne %) vjetore e drejtimite te eres.

Shpejtesite e eres ne territorin ne studim jane ne vartesi te periudhes se vitit.

Vlerat me te medha te shpejtesise se eres vrojtohen ne stinen e dimrit.

Shpejtesite maksimale te eres me periudhe perseritje nje here ne 50, 20, 10 vjet jane respektivisht 30-33m/s, 28-30m/s, dhe 24-27m/s (sipas Kushteve teknike Hidrometeorologjike).

### Temperatura

Regjimi termik paraqet uniformitet te kenaqshem. Vleftat e temperatures mesatare vjetore pergjithesisht luhaten rreth 13.0o C. Temperatura mesatare e janarit lekundet ne rreth 2.9 oC.

Ne tabelen 4 jepen vlerat mesatare mujore e vjetore te temperatures se ajrit nga te



# Pogradec – Qafë Plloçë”

dhenat e stacionit Prenjas i Quksit;

Ecuria ditore e temperatures se ajrit, ne cdo stine dhe muaj te vitit, shprehet nga nje vale pothuajse sinusoidale, qe karakterizohet nga nje maksimum ne oret e para te pasdites dhe nga nje minimum rreth kohes se lindjes se diellit.

Me 18 korrik 1973 ne stacionin Prenjas i Quksit eshte regjistruar temperatura maksimale 39.1 oC.

Dukuria e uljes se temperatures minimale deri ne vlera negative eshte, pergjithesisht, vecori e muajve te dimrit. Por te tilla

mund te vrojtohen, pjeserisht, edhe gjate marsit e tetorit.

Me 5 janar 1980 ne Prenjas eshte regjistruar temperatura minimale -19.0 oC,

Regjimi termik i ajrit dhe i tokes duhen pare ne kompleks. Dihet se temperatura e ajrit dhe e tokes ne te njejtin moment nuk jane te njellojta. Ajri nuk ngrohet drejtpersedrejt nen veprimin e rrezeve te diellit, por nga nxehtesia qe leshon toka.

Ne teresi ecuria vjetore e temperatures mesatare te shtreses siperfaqesore te tokes (0 – 20 cm thellesi) eshte e ngashme me ate te ajrit. Vlerat me te larta vrojtohen ne muajt e veres, ndersa ato me te ulta ne muajt e dimrit. Ne ecurine e temperaturave te tokes verehen dy momente kryesore:

a) periudha kur temperatura mesatare rritet me rritjen e thellesise dhe

b) periudha kur kjo temperatura ulet me rritjen e thellesise.

Tendenca e rritjes se vlerave mesatare te temperatures se tokes nga siperfaqja ne drejtim te thellesise duket, pergjithesisht, nga fundi i muajit shtator.

Dukuria e uljes se vlerave mesatare te temperatures se tokes nga siperfaqja ne thellesi, eshte vecori e muajve te gjysmes se ngrohite te vitit.

## Reshjet atmosferike

Termi reshje, i perdorur ne hidrologji, perfshin te gjitha format e ujirt qe vijne nga atmosfera ne toke. Format kryesore te reshjeve jane: shiu, bora, bresheri, vesa etj.

Reshjet atmosferike jane nga elementet me te rendesishem te motit dhe te klimes.

Faktoret kryesore qe kushtezojne sasinë, intensitetin, shperndarjen vjetore, stinore e mujore te reshjeve, ne zonen ne studim jane: pozicioni geografik dhe vecorite e relievit.

Eshte e qarte se per nje pellg, pergjithesisht, reshjet

jane faktori kryesor i regjimit hidrologjik, sepse ato jane vete edhe materiali kryesor qe krijon rrjedhjen ne hapësire dhe kohe.

Nje karakteristike e pergjithshme e shperndarjes se reshjeve ne pellgun e Shkumbinit eshte se lartesia e tyre rritet nga Perendimi ne Lindje deri ne pellgjet e degeve Gos-time e Rapun (inklusiv) dhe pastaj zbret nga Veriu ne Juge.

Reshjet atmosferike jane nga elementet me te rendesishem te motit dhe te klimes.

Ne tabelen 5 jepen reshjet vjetore per stacionet Pogradec, Prenjas, Llenge dhe Stravaj.

Ne territorin ne studim, gjate vitit bien mesatarisht 1424

mm ne Stravaj dhe 763 mm ne Pogradec.

Ne territorin ne studim, gjate vitit bien mesatarisht 1424 mm ne Stravaj dhe 763 mm ne Pogradec.

Shperndarja e reshjeve brenda vitit ne territorin ne studim eshte tipike mesdhetare, me reshje te shumta gjate gjysmes se ftohte te vitit dhe reshje te pakta gjate gjysmes se ngrohite me thatesire qe mund te zgjate disa muaj.

Ndarja e vitit ne dy gjysma viti eshte bere duke ndjekur kriterin pluviometrik te muajve. Si gjysme e ftohte e vitit eshte marre inkluziv periudha tetor... mars ndersa ajo e ngrohite periudha prill...shtator.

Nga analiza e reshjeve, te dy periudhave, vihet re se reshjet e gjysmes se ftohte te vitit jane me te medha se ato te gjysmes se ngrohite, gje qe tregon karakterin mesdhetar te shperndarjes se reshjeve ne territorin ne studim.

Po te shohim ecurine e sasisë se reshjeve sipas renditjes kronologjike te muajve, do te veme re se kjo ecuri paraqet afersisht trajtat e nje kurbe paraboloidi me origjine te vendosur ne muajt me me pak reshje dhe me krahe ne te dy drejtimet qe ndjekin rritjen graduale te reshjeve sipas radhes se muajve (shiko fig. 2.).

Muajt me me shume reshje jane Nentori, Dhjetori e Janari, por reshjet me te shumta vrojtohen ne muajin Nentor. Muaji me me pak reshje eshte Korriku.

Nga sasia e reshjeve mbizoteron stina e dimrit, megjithese vjesh-ta ne disa raste barazohet me te.

Ditet me reshje me te medha se 1 mm mesatarisht lekunden nga 95 ne 105 dite.

Ne figurat, 2, jepet shperndarja mesatare mujore e shtreses se reshjeve per vendmatjet meteorologjike Prenjas.

## 12. KOMUNITETI LOKAL DHE SOCIAL-EKONOMIA

### 12.1. PERSHKRIMI I PERGJITHSHEM

**Komuna Qukes** ndodhet ne Shqiperine e mesme, ne juglindje te qytetit te Librazhdit. Nga jugu ne veri komuna pershkohet nga lumi Shkumbin dhe rruga nacionale Librazhd – Pprenjas.

Ne afersi te Qukesit ka qene stacion i rruges Egnatia, me emrin “Tres Tabernas”. ne jugperndim ndodhen muret e nje qyteze ilire, tashme nje monument kulture.

Lartesia mbi nivelin e detit varion 450m deri 2000 m. Me

10675 banore. Shtrihet ne nje siperfaqe prej 8.3 km2. Sot dega kryesore e ekonomise eshte bujqesia. Sot aty veprojne 38 biznese Siperfaqja e tokes bujqesore eshte 1742 ha dhe siperfaqja e pyjeve dhe kullota eshte 6582 ha.. Ka 10 grupe femijesh, 4 shkolla 9-vjecare, 5 shkolla filllore dhe 2 shkolla te mesme te pergjithshme. .

**Bashkia Pprenjas** ndodhet ne Fushë. Popullsia sot eshte

10675 banore. Shtrihet ne nje siperfaqe prej 8.3 km2. Sot dega kryesore e ekonomise eshte bujqesia. Sot aty veprojne 38 biznese Siperfaqja e tokes bujqesore eshte 1742 ha dhe siperfaqja e pyjeve dhe kullota eshte 6582 ha.. Ka 10 grupe femijesh, 4 shkolla 9-vjecare, 5 shkolla filllore dhe 2 shkolla te mesme te pergjithshme. . Bashkia Pprenjas ndodhet ne Fushëgropen e Pprenjasit. Fushe – gropa e Pprenjasit shtrihet midis malit te Shebenikut ne veri dhe malesise se Mokres ne jug. Ne lindje shkon deri ne rreze te Qefe-Thanes dhe kurrizit te Muçalit, ndersa ne perendim kurrizi i ulet e kodrinor i Rrashtanit e ndan nga lugina e Shkumbinit te siperm. Bashkia Pprenjas kufizohet me komunën Rrajce (Rrethi Librazhd), komunën Prepsht (rrethi Pogradec), komunën Stravaj (rrethi Librazhd) dhe komunën Qukes (Rrethi Librazhd) Ajo perbehet nga tre fusha kryesore: fusha e Domosdoves, fusha e Rajces, fusha e Katjelit dhe shtrihet ne lartesine nga 578m ne rreth 678m mbi nivelin e detit. Fushe –gropa e Pprenjasit ben pjese ne gropat me te reja te riparterira ne pliocen dhe kuaternar dhe eshte e pasur me depozitime liqenore te cilat deshmojne per ekzistencen e nje liqeni, qe ka mbuluar dikur gjithë gropen. Qyteti i Pprenjasit, si qytet, filloi me ndertimin e vendbanimit te punetoreve te hekur-nikelit te minieres se Pishkashit ne vitin 1953 dhe u be qendra e sektorit te kesaj miniere. Nje vit me vone filloi ndertimi i qytetit te punetoreve duke marre emrin e fshatit te Pprenjasit, i cili ndodhet aty afer. Nder deget kryesore te ekonomise ka qene ajo e nxjerrjes se hekur-nikelit. Permen-det ne historine e mesjetes per nje nga betejat me te ashpra te

Skenderbeut kunder push-tuesve osmane zhvilluar me 1445, ne fushen e Mokres. Bashkia Pprenjas perfshin 1 qytet dhe dy fshatra: qyteti i Pprenjasit, fshati Pprenjas- Fshat dhe fshati Rrashtan. Popullsia sot eshte 8281 banore. Shtrihet ne nje

siperfaqe prej 1830ha.

Dega kryesore e ekonomise sot eshte bujqesia, industria minerale e hekur-nikelit. Sot aty veprojne 16 biznese. Siperfaqja e tokes bujqesore eshte 569 ha dhe siperfaqja e pyjeve dhe kullota eshte 617 ha Ka 1 kopesh femijesh, 3 shkolla 9-vjecare, 3 shkolla filllore dhe 1 shkolle e mesme e pergjithshme.

**Komuna Proptisht** është një komunë në Rrethin e Pogradecit.

Komuna Proptisht perfshin keto fshatra:

Proptisht, Rodokal i Siper, Rodokal i Poshtem, Homezh, Golik, Selce e poshtme, Slabinje, Somotine, Krickove, Slatine, Baribaedhe, Homcan, Verri, Zall-Torre dhe Selishte.

Komuna Proptisht ka nje populllesi prej 6885 banore.

**Komuna Trebinjë** është një komunë në Rrethin e Pogradecit perfshin keto fshatra:

Çezmë e Madhe · Çezmë e Vogël · Dunicë · Guri i Bardhë · Lllëngë · Kalivaç · Hondisht · Selcë e Sipërme · Malinë · Podgozhan · Pevellan · Plenisht · Trebinjë

Komuna Trebinje ka nje populllesi prej 3613 banore.

**Komuna Çërravë** është një komunë në Rrethin e Pogradecit perfshin keto fshatra:

Çërravë, Leshnicë ,Pretushë ,Blacë, Alarup, Grabovicë · Qershizë · Nishavec · Bletas · Kodras · Lumas Komuna Çërravë ka nje populllesi prej 9682 banore.

Komuna Çërravë është një komunë në Rrethin e Pogradecit perfshin keto fshatra: Çërravë, Leshnicë ,Pretushë ,Blacë, Alarup, Grabovicë · Qershizë · Nishavec · Bletas · Kodras · Lumas Komuna Çërravë ka nje populllesi prej 9682 banore.

**Komuna Dardhas** është një komunë në Rrethin e Pogradecit perfshin keto fshatra: Dardhas · Dërdushë · Osnat · Lekas · Niçë · Grunja · Stërkanj · Prenisht · Stropckë

Komuna Dardhas ka nje popullsi prej 3619





# Avni Gjona, partizanin që e ndoqi pas hija e komunizmit

Nga Flori SLATINA

Fisi Gjona i Lakteshit është një ndër fiset më të dëgjura me tradita patriotike në Mokër. Shekulli XX, por edhe më parë, qenë vitet 800, nga ky fis kanë dalë burra të shquar, të cilët e lartësuan edhe më shumë emrin e trungut të tyre. Gjatë Luftës së Parë e të Dytë Botërore, ky fis u bë protagonist në një sërë ngjarjesh, të cilat politika e kohës i shfrytëzoi në dobi të saj e në kurriz të fisit Gjona. Liko Gjona ishte një ndër ata burra të shquar e të nderuar të Mokrës, që renditej me emra të tjerë burrash të rrallë të Mokrës.

Avni Gjona (Xha Avniu) sot është 87 vjeç. Prej disa vitesh jeton me djalin e nipërit në Tiranë dhe gëzon shëndet të mirë. Ai është dëshmitar i disa epokave, por që të gjitha u sollën ashpër me të dhe thajse asnjëherë nuk e vlerësuan aq sa duhet kontributin dhe punën e tij. U lind në Laktesh, më 05 shkurt 1926. Shkollën fillore e kreu në Velçan e më pas në Pogradec, por që e ndërpreu për shkak të pushtimit fashist më 1939. Kreu vetëm katër klasë shkollë, por që më pas iu desh të mësonte universitetin e jetës. Që në moshë të re, u përfshi nga entuziazmi patriotik dhe jehona e Çetës së Mokrës ndikoi edhe tek ai e shumë të rinj mokrarë, të cilët, u përfshinë njeri pas tjetrit në lëvizjen antifashiste. Xhaxhai i tij, Liko Gjona, më herët ishte përkrah lëvizjes komuniste dhe ka qenë miku i Enver Hoxhës e Reshit Çollakut. Në vitin 1944 u rresh-tua në radhët e Batalionit "Reshit Çollaku", i cili u inkuadrua si pjesë e Brigadës së 9 Sulmuese, me komandant Isuf Keçin. Si pjesë e kësaj Brigade ai për disa ditë qëndroi në Mujazë ku zbankuan forcat aleate angleze të cilat furnizuan me veshmbathje e pajisje ushtarake forcat partizane. Ka marrë pjesë në një seri aksionesh luftarake, deri në çlirimin e plotë të vendit. Pas dëmeve të shumta në njerëz që pësoi Brigada e Parë, atij dhe gjithë shokëve të Brigadës së (iu desh të udhëtonte nga Korça në Krujë në këmbë, në kushte të mjaft të vështira).

Në radhët e ushtrisë qëndroi 6 muaj në Durrës e më pas edhe në Kukës, në Pukë, ku edhe u pranua në Parti.

Me çlirimin e plotë të vendit, ai u inkuadrua në radhët e policisë popullore, fillimisht në Shkodër e më pas në Tiranë. Kur komunistët morën fuqinë e shtetin në dorë, filluan gjuetinë e tyre ndaj elementëve që ata i konsideronin të rrezikshëm, por edhe ndaj fiseve e familjeve të mëdha. Ndaj Avniut u provokua një sërë incidentesh, të cilat çuan deri në lirimimin e tij nga radhët e policisë dhe shkarkimin e tij nga Partia. Kjo ishte një goditje e rëndë për çdo njeri, sepse automatikisht ti shpalleshe arnik i atij regjimi dhe jeta jote ishte në fije të perit. Si pretekst u gjetën dy xhaxhallarët e tij, Selman dhe Ramadan Gjona, të cilët ishin rreshtuar në radhët e Ballit, madje Ramadan dha edhe jetën



Avni Gjona

në luftë. Nuk u mor fare parasysh se Avniun kishte qenë partizan, me armë në dorë, si efektiv i Brigadës së 9 Sulmuese, as fakti se ishte anëtar partie i 1944-s, as si pjesëmarrës në radhët e policisë së shteti. Madje nuk u mor parasysh as xhaxhai tjetër, Liko Gjona, i cili ishte i lidhur me Partinë dhe njeri i besuar i Enver Hoxhës. As fakti se edhe kunati i tij, Sheme Sinani kishte rënë dëshmor, partizan.

Goditja e njerëzve të partisë ishte në modë dhe kjo bëhej me shumë për të trembur e mbajtur në fre atë popull, që nuk kursente as njerëzit e tij më besnikë e njerëzit e besuar. Avniu u shpall kulak dhe pasojat ranë për gjithë fisin, fëmijë, nipër e mbesa. Sistemi komunist e detyroi Avniun dhe gjithë fisin Gjona të punonte në punët më të vështira të bujqësisë dhe për disa vite edhe në pyjet e Bishnicës, në punë të rënda fizike. Fëmijët i ngelën pa shkollë e pa punë. Duhet të kemi parasysh faktin se jetonte në Laktesh dhe regjimi komunist në atë fshat ka qenë shumë më i keq, më i egër e më i rëndë se kudo në Mokër, për shkak edhe të drejtuesve të ashpër e të verbër të asaj kooperative.

Gjendja e rënduar politike e ekonomike vazhdoi deri në rënien e komunizmit. Me ardhjen e demokracisë erdhën ditë më të mira, liria e dëshiruar, por që Xha Avniu, falë zotit, pati mundësi ta shijonte këtë kohë, edhe pse ka dalë në pension prej disa vitesh. Në demokraci iu njohën kontributet e tij si në luftë ashtu edhe në punë. Prej disa vitesh e merr edhe kontributin e partizanllëkut, të cilin qeveria komuniste nuk ia njohu asnjëherë. Sot ai jeton në Tiranë, ku ka disa vite që është larguar nga Lakteshi, por që me shpirt e zemër mbetet andej, pasi edhe kjo verë e gjeti atje në vendlindje ku e lidhin shumë kujtime, e lidh gjaku, e kaluara, të parët e tij që prehen atje. Jetojmë në një kohë tjetër, por që do të ishte më e lehtë e më e bukur, nëse vërtet ai e gjithë pasardhësit e tij do të shpërbleheshin për të kaluarën e tyre të hidhur.

Jetë të gjatë xha Avniu!

# ISUF MYZYRI DHE POGRADECI

Nga Zabit ÇUKU

Mjeshtri i këngës popullore Isuf Myzyri lindi në Elbasan, nga një familje e varfër qytetare, më 8 mars 1881. Pas punës së lodhshme Isufi që në moshë të re bashkohej me shokët dhe krahas aktiviteteve të tjera rinore këndonin edhe këngë popullore qytetare të trashëguara në trevën e Elbasanit. Isufi dallohej nga zëri i tij i ëmbël, nga mprehtësia e degjimit, të e të hollë që kishte nga të tjerët. Duke patur këto dhunti ai u shkëput nga znati si trashëgues i berberit dhe i kushtohet shpirtit të këngës dhe muzikës.

Në fillim i kushtoi duke ja arritur qëllimit ai mësoi, instrumentin e violinës, e kjo i dha mundësi që të mbledhë e aktivizojë rreth vetes shumë shokë e dashamirës të këngës, muzikantë të talentuar me instrumenta popullore e krijuar një orkestër popullore. (Thanas Meksi "Mjeshtri i këngës popullore, Isuf Myzyri" Elbasan 2001, faqe 20).

Ajo orkestër e vogël krijoi një emër të mirë, jo vetëm në Elbasan por edhe në Pogradec, Korçë, Tiranë, Berat e tjerë. Fillimin kjo orkestër e ka në vitin 1905, e cila nuk ishte parë ndonjë herë. Kjo krijoi repertorin e saj me këngë patriotike e historike, erotike, të dasmave, e tjera.

Isuf Myzyri është marrë me zanatin si qeleshe punues popullor në jetesën e tij, ka dhënë një kontribut në shkencën etnografike shqiptare. Ai ndryshoi shumë profesione e zanate por i qëndroi besnik profesionit të këngëtarit, të muzikantit popullor duke e kënduar në origjinalitetin e saj. Këngët i krijonte vetë dhe në shumë raste vjershat e Isuf Myzyrit i ka shkruar mësuesi Ritvan Palluqi, i afërm i Isufit. Për një periudhë më pak se dhjetë vjeçare (1929-1939), Isuf Myzyri mundi të kompozojë 16 këngë nga të cilat më të njohura janë: "më mirë në pyll se në qytet", "në zabel të gjeta", "një lul ishte me trëndafil" e tjera.

Këngët e Isuf Myzyrit u ngritën dhe ndriçuan nga këngëtarët e medhenj të Shqipërisë dhe Kosovës të shekullit të 20-të, si Tefta Tashko Koço, Marije Kraja, Nexhmije Pagarusha dhe Vaçe Zela. Me rastin e 75 vjetorit të lindjes ai dekorohet nga Kuvendi Popullor me urdhërin e Punës të Klasit Dytë. Ai ndahet nga jeta më 21 tetor 1956, në moshën 75 vjeçare. Më 31 gusht të vitit 1978, Kuvendi Popullor i jep Isuf Myzyrit titullin e lartë "Artist i Popullit", dhe asambli popullor i Elbasanit mban emrin e "Isuf Myzyrit".

Lasgush Poradeci ka pasur lidhje me Isuf Myzyrin. Kur ishte në Llixhat e Elbasanit ai shkruan: E mërkurrë 25 shtator 1940, erdhi në Llixha vjershetori, violinisti popullor Isuf Myzyri nga Elbasani, u takua me mua. Kishte sjellë edhe violinën dhe i ra disa herë melodive të këngëve të tij. U kënaqëm shumë. E entje 26 shtator 1940, hëngra darkë tek kroi i Jug-Perendimit, (krua në lloji pusi), sot përpara dhe pas dreke shkrojta këngët e Isuf Myzyrit, prej gojës së tij (në Llixhë).

E djelë 29 shtator 1940, u fjalosa për herën e fundit me këngëtarin Isuf Myzyri. Erdhi që në mëngjes (ora 7.30) në hotel "Park", pas dreke shkoj në Elbasan.

(Lasgush Poradeci, vepra 3, "Onufri", faqe 214-215)

Lasgushi, Isuf Myzyri deshi ta takoj përsëri dhe tregon: Shkova te kafeja ku rrinte zakonisht. Pyeta -ishin ca pleqbektashinj. Ka kaluar më thanë. Shiko sa bukur! Nuk më thanë vdiq, apo ka vdekur, po ka kaluar, d.m.th. ka kaluar në jetën tjetër. Isuf Myzyri ka kaluar, por



Usta Isuf Myzyri

poezinë e tij e mbajnë mend. (Shkrimtari Petraq Kolevica, shok i Lasgush Poradecit e ka treguar).

Isuf Myzyri kishte lidhje me muzikatët pogradecarë e Dorova. Ata në vitin 1955 shkuan në Elbasan për të dhënë koncert muzikor. U vendosën tek turizmi i vjetër dhe çdo darkë u binin veglave muzikore.

Në atë periudhë ishte orkestra më e mirë. Metka i binte xhezit, Agimi i binte kitarës, dhe Ilirjani i binte fizarmonikës. Ishte e vështirë në kohën kur luante orkestra, të gjeje vende për t'u ulur.

Orkestra Dorova kishte repertor të larmishëm dhe shumë i këndshëm, luannin edhe pjesë nga repertori botëror, që pëlqeheshin shumë edhe në Elbasan. Muzikantët pogradecarë interpertonin shumë këngë të Shqipërisë mesme, dhe veçanërisht të këngëtarit Isuf Myzyri.

Isuf Myzyri kishte dëgjuar për muzikantët pogradecarë dhe një ditë këta i shkuan për vizitë në shtëpi. Ishtë viti i fundit i jetës dhe këngëtarit Isuf Myzyri, kishte zënë krevatin dhe s'leviste dot. Këngatari Isuf Myzyri u thotë: "Rrofshi more djema, që keni ardhur! Faleminderit dhe per interpertimin e këngëve të mija, që i bini çdo natë në Turizëm, Elbasan.

(Thanas Meksi "Mjeshtri i këngës popullore, Isuf Myzyri" Elbasan 2001, faqe 70).

Vëllezërit Dorova, poradecarë e falenderuan dhe të gëzuar u larguan nga shtëpia e Isuf Myzyrit. Jo vetëm në Elbasan, por në çdo gëzim e festë që shkonin ata, në repertorin e tyre përfshinin edhe këngët e bukura të Isuf Myzyrit.

Pogradeci dhe Elbasani kanë patur lidhje në çdo zakon e traditë, po ashtu kanë patur edhe në këngën, muzikën, sofrën dhe këngën popullore. Pogradeci ka pasur një respekt të madh po edhe ka për këngët e Isuf Myzyrit. Ai si këngëtar popullor, ka dhënë një ndihmesë të shquar në pasurimin dhe zhvillimin e këngëve folklorike. Ka qenë krijues i veglave muzikore popullore, i ka kënduar cilësive dhe virtuteve të larta të shqiptarit! trimërisë, besës dhe bujarisë të popullit tonë, luftës Nacional-Çlirimtare kundër pushtuesëve dhe tradhëtarve të vet.

Le ti pasurojmë më tej këto tradita nëpërmjet bashkpunimit dhe respektit të ndërsjelltë midis terevave dhe krahi- nave tona.

Kryeredaktor: Flori SLATINA

Redaksia: Haki BALLIU, Zenun FERRO, Istref HAXHILLARI, Zabit ÇUKU, Sami LEKA, Pëllumb ZADE, Llazi TONA, Ariz DURBAKU

Pëllumb ZADE, kryetar i shoqatës "Pelioni"  
Istref Haxhillari, Zabit Çuku, nënkryetarë të shoqatës  
Zenun FERRO, sekretar i shoqatës

Që nga numri 111 gazeta "Mokra" ka dalë në internet, ne adresën e mëposhtme:

www.pogradeci.com/mokra



# Homazh për nënë Alije Feron

Mësuam me dhimbje, se më 26 maj 2013 u nda nga jeta, familja, miqtë dhe të afërmit, nëna e dashur dhe e nderuar Alije Halil Fero. U lind në fshatin Senisht, Pogradec më 4 korrik 1927. Fëmijërinë dhe rininë e ka kaluar në fshatin Senisht, me familjen e saj, një familje patriotike dhe mbeshetese dhe bazë e Luftës Nacional Çlirimtare (1942-1944).

Në vitin 1945 u martua me Islam Feron, në fshatin Slabinjë, Pogradec. Punoi në pronën private, dhe nga viti 1957 deri 1982 në kooperativë bujqësore të Slabinjës, pas kësaj ishte në pension deri sa u nda nga jeta.

Rriti dhe edukoi me dhëmbshurinë e nënës, një vajzë dhe pesë djem, nipër e mbesa. Për vajzën Lavdie ajo e kujtoi me shumë dhëmbshuri tërë jetën, sepse ajo u nda nga jeta në moshën gjashtë vjeçare në korrik të vitit 1953.

Djemtë e saj, Zenuni, Zeneli, Xhemali, Lavdimi e Ramizi u rritën nga dora dhe zemra e saj, tani ata kanë krijuar familjet e tyre, dhe e përcollën në banesën e fundit me të gjitha nderimet dhe respektin që i takon.

Në vitin 1996, djali i saj Ramis Fero, shkon me banim në Çermë Sektor, Lushnjë (Tërbuf) të rrethit të Lushnjës. Ajo së bashku me bashkëshortin shkoj të banonte pranë djalit të saj në Çermë Sektor, Lushnje për 17 vite.

Ajo rriti nipër e mbesa, të cilët e për-



collën me nderime në banesën e fundit. Ajo mbillte vetëm dashuri, respekt, e mirënjohjeje. Edhe nuset e djemve, Luljeta, (Burreli), Nënta (Pogradeci), Donika (Pogradeci), Sofika (Pogradec) e Luli (Pogradec) i bënë respektin e plotë duke e përcjellë me shumë nderime vjerrën e tyre Alije Fero. Ajo për to ishte një nënë e dytë dhe e dashur. Zoti e ndau nga jeta në moshën 86 vjeçare, dhe i lehtë qoftë dheu atje ku pushon.

Përveç të afërmëve, miqve dhe fisit në këtë ceremoni morën pjesë edhe shume shokë e miq të djemëve saj nga Tirana, Elbasani, Mokra e Pogradeci në respekt të nënës Alije dhe të djemëve të saj.

Në emër të Shoqatës Atdhetare e Kulturore "Pelinoni" ku i biri i saj, studiuesi Zenun Fero, ku ka qënë një nga më aktivistët e Shoqatës, dhe të gazetës "Mokra", u shprehim ngushëllimet më të sinqerta, bashkëshortit Isalm Fero i cili e ka mbajtur dhe respektuar duke kaluar një jetë të gjatë e të bukur me Alijen, fëmijëve, nipave dhe mbesave të saj.

I pa harruar qoftë kujtimi i saj!

I lehtë qoftë dheu atje ku pushon.

**Nga Stafi i Shoqatës "PELIONI" e gazetës Mokra.**


**Haki Balliu, Pëllumb Zade,**

**Flori Balliu, Zabit Cuku,**

**Sami Leka, Bujar Balliu,**

**Isterf Haxhillari, Koço Pihoni.**

**Aris Durbaku,**



## HOMAZHE PËR PANDELI SPIROLLARIN

**P**ara pak ditësh u nda nga jeta Pandeli Vangjel Spirollari. U lind në Niçë të Pogradecit në një familje atdhetare. Sipas akademikut Prof.Dr.Antonio Batdage dhe shkrimtarit Kostandin Burelinao në librin "Rremene de Albanie" botuar më 1905 në Tipografinë Mbretërore, Bolonjë, Itali, faqe 71 shkruajnë: "Niça u thmelua dhe u bë e ribanueshme për të dytën herë nga familja Spiro apo Spirollari, familja më e vjetër dhe më antike".

Urrejtja kundër zaptuesit Osmanllin ndjehej edhe në familjen Spiro apo Spirollari ku ata morën pjesë dhe luftuan me trimëri kundër pushtuesve ottoman deri në dëbimin e tyre nga Shqipëria me fitoren e Pavarësisë më 28 nëntor 1912. Kjo familje u lidh dhe me LANÇ-re. Gjyshja e Pandeliut Zaharia e bija e Jasko Koneshit, e motra e patriot At Dhimitër Kokoneshi dhe mbesa e udhëheqësit kryengritës të krahinës së Mokrës Tun Kokoneshit u këndonte nipërve dhe mbesave këngë patriotike për trimat e zonave Mokër-Gorë-Opar që luftuan me heroizëm pushtimit ottoman dhe pushtimit nazi-fashiznë vendin tonë.

Ky mjedis patriotiko-kulturor ushqen tek Pandeliu qysh në fëmëni dashurinë për atdheun, njeriun dhe punën. Ai pasi mbaroi shkollën në vendlindjen e tij, fronti i punës së tij u bë bujqësia. E nisi punën në SMT me traktorin për të punuar tokën, për të mbjellë dhe shirë drithërat e bukës nëpër fshatrat e rrethit të Pogradecit. Njeri me edukatë shembullore dhe shpirt të gjerë, traktorist i talentuar në profesion i cili u dekorua për punën me ndërgjegje të lartë. Ai la pas bashkëshorten Vjollca dhe djalin Vangjel, që do ta kujtojnë me respekt e dashuri Pandeliun e shtrënjtë, që i donte dhe e donin shumë. U nda nga jeta më 28 maj 2013 dhe u përcoll me nderimin e duhur për në banesën e fundit.

I përjetshëm kujtimi e tij

**Llazi TONA**

## QARKU I ELBASANIT NDERON FIGURAT PATRIOTIKE

# Një jetë kushtuar atdheut

Nga Kujtim STONA

**P**ara disa ditësh, më 4 qershor, Qarku i Elbasanit nderoi një prej figurave të rëndësishme patriotike, Hamit Hallidrin, nga rrethi i Librazhdit. Në këtë veprimtari përkujtimore dhe nderuese u vlerësua një prej emrave të nderuar patriotë të fillimshkullit XX. Hamiti u lind në vitin 1860. Mbaroi shkollën teologjike në Stamboll në 1883. Po këtë vit emërohet mësues në fshat (Metep), jepte mësim në gjuhën turqisht. Në Stamboll u njoh me shumë patriotë si Halit bërzeshta, Aqif Pashë Elbasani, dhe vëllezërit Qiriazzi. Në vitin 1884 futi në fshat abetaren në gjuhën shqipe. Atë vit e zbuloi një këshilltar turk dhe e heqin nga puna. Për këtë Hamiti u vret këshilltarin turk dhe u dënua nga gjykata me burgim të përjetshëm. Arrin të arratiset në 1908 me një grup tjetër shqiptarësh e u vu në mbrojtje të kongresit të Manastirit. Në 26 nëntor 1912 ishte në ngritjen e flamurit në Elbasan, ndërsa në vitin 1920 edhe në Luftën e Vlorës, si dhe në mbrojtje të Kongresit të Lushnjës. Ai ishte patriot, arsime dashës, njohës i disa gjuhëve dhe një luftëtar i paepur i çështjes sonë kombëtare. Atë nuk e përkulën as joshjet e Portës së Lartë, as kërcënimet e burgjet e saj, por as edhe burgjet e internimit e mëvonshme. Ai vdiq i helmuar në vitin 1932, pas tre vjetësh internim, por la pas një emër për t'u kujtuar e nderuar, por që diktatura komuniste as nuk e nderoi e as e kujtoi, sepse shkak ishte i biri, edhe ky një patriot, por i pëpadëshiruar për atë sistem antivlerash.



Xhelo Hamit Hallidri në vitet e Luftës së Parë Botërore luftoi me të atin e tij në të gjitha veprimet luftarake deri në vitin 1920 ku fshati i tij u dogj për tre herë nga ushtritë serbe, bullgare e austriake që e shkelën atë zonë. Po më 1920 mori pjesë në Luftën e Vlorës dhe në Revolucionin Demokratik të vitit 1924. Për veprimtari patriotike në vitin 1933, kur nuk ishte mbushur viti nga vrasja e të atit, në internim, ai u burgoset fillimisht në Elbasan dhe si bashkëpunëtor me Riza Cerrovën u riburgoset në vitin 1935, si pjesëmarrës në Lëvizjen e Fierit. Në kohën e pushtimit fashist të vitit 1939, Xhelo Hallidri mblodhi disa miq të tij dhe bashkë me disa Kryepleq të fshatrave përreth vajtën në Komunën e Qukës për të kërkuar armë por kjo gjë u bë e pamundur nga qëndrimi negativ i drejtuesve të Komunës për këtë çështje. Prandaj u detyruan të shkojnë në Durrës ku ishte njohur me Abaz Kupin dhe bënë qëndresë disa ditore kundër italianëve.

Italia fashiste në këtë kohë kërkoi që të zhdukeshin organizatorët e rezistencës dhe një ditë shtëpia e Xhelo

Hallidrit në Rrajcë u gjet e rrethuar nga ushtarë italianë të cilët zbranznin pushkët e mitrolozët për të kapur Xhelon gjë të cilën ata nuk e arritën dot. Prandaj dhe morën peng të emën, të shoqen dhe djalin e vogël dhe i internuan në Peqin. Për këtë veprim mizor Xhelo Hallidri krijoi një njësi të armatosur nacionaliste dhe mbështeti organizimin e rezistencës popullore. Për të forcur pozitën e tij ai bashkëpunoi me çetat e tjera nacionaliste dhe në vitin 1944, në vendin e quajtur Qafa e Kuqe, në rrugën Qafë-Thane-Strugë i bënë pritë një autokolone gjermane.

Me thirrjen e Konferencës së Pezës në vitin 1942 Xhelo Hallidri nënshkroi një marrëveshje në shtëpinë e Ali Myftiut në Elbasan me Nacional-Çlirimtaren me qëllim që së bashku të luftohej okupatori e të formonin qeverisjen e vendit sipas vullnetit të popullit pas çlirimit. Në këtë marrëveshje që u nënshkrua nga të dy palët morën pjesë dhe Kahrem Ylli e Misto Treska nga Nacional-Çlirimtarja. Por pas marrëveshjes së Mukjes forcat komuniste të maskuara shkelën marrëveshjen e nënshkruar dhe njësisë së Xhelo Hallidrit i kthyen armët.

Si njeri me horizont kulturor të gjerë Xhelo Hallidri në atë kohë zotëronte një aparat radiomarrës me bateri dhe ndiqte emisionet e veprime luftarake nga Kajro i Egjiptit. Ai zotëronte mirë gjuhën turke, serbe, gjermane dhe angleze dhe kjo gjë e ndihmonte mjaft në trimëritë dhe zotësinë e tij në shërbim të atdheut.

Dy ditë para se të kapitullonte Italia Xhelo Hallidri rrethoi garnizonin Italian në Përrenjas dhe me anë të një ultimatumit i kërkoi kolonelit Italian që të dorëzonin armët ose përndryshe do t'i zhdukte krejt komandën. Duke shfrytëzuar trimëritë e tij e të çetës së vet Xhelo Hallidri i rrëmbeu italianëve 1000 pushkë dhe dhjetëra mitrolozë, topa e murtaja dhe krejt garnizonin Italian e mori gjermani si robër.

Burrëria dhe trimëria e Xhelo Hallidrit në këtë kohë kishin marrë nam të madh në krahinë. Ishte trimëria dhe autoriteti i Xhelos që shpëtoi fshatin Urakë nga shfarosja gjermane. Po ashtu në Çezmë të Mokrës me forcën e tij shpëtuan nga pushkatimi dhjetëra njerëz.



# Ohri, qyteti i dritës

Nga Fahri KHARRA

Disa emërtime gjeografike si Nishi, Shtipi, Ohri iu erdhën Sllavëve nga goja e arbanasve, e cila ndoshta kishte mundur të paraqes mundësinë që shqiptarët të kenë jetuar në lokalitetet e përmendura që para ardhjes së Sllavëve.” (Bogumil Hrabak “Širenje arbanaskih stocara po ravnica i slovenski ratari srednjovekovne Albanije” Burimi): “Stanovništvo slovenskog porijekla u Albaniji” – Zbornik radova sa medunarodnog naucnog skupa održanog na Cetinju 21, 22. i 23. juna 1990. godine) Nga ky paragraf i cekur shihet se sa sllavët, janë plagjiatorë të historisë dhe okupatorë të një toke të huaj, por në shkrimet e tyre nuk e kanë të mundshme që t’ikin krejtësisht e të mos e tregojnë të vërtetën.

“Jemi te Ohri dhe historia e tij shqiptare, por e stërvjedhur nga ardhacakët. Në antikuitet (shënime sllave) qyteti njihet me emrin e vjetër “Lychnidus” që ndoshta do të thoshte “qyteti i dritës” ose “guri i çmuar që lëshon dritë”. Por pas vitit 879 psK nuk quhej më Lychnidos, por sipas sllavëve Ohrid, që ndoshta rrjedhë nga fjala sllave “vo hrid” me kuptimin “në breg” sepse qyteti i vjetër ishte në majë të bregorës buzë liqenit”. E shifni, një rrenë tjetër e zakonshme sllave me qëllim të humbjes së çdo gjurmëje shqiptare. Por është e pamundur!

Banorët e herëshëm të regjionit të gjerë të Liqenit të Ohrit (Bogumil Hrabak... Disa emërtime gjeografike si Nishi, Shtipi, Ohri iu erdhën Sllavëve nga goja e arbanasve...) ishin Dasaratët dhe Enkelejt (fise Ilire). Zbulimet në vazhdimësi tregojnë që qyteti banohej edhe nga Filip i II-të i Maqedonisë (Origjina ilire e Aleksandrit të Madh).

Më lartë kemi sjellë origjinat familjare të Filipit II dhe Olimpisë që vijnë nga fiset ilire. Filipi ishte djali i Euridikës, e cila vinte nga fisi ilir i Lynkestëve. Filipi ishte lindur nga një nënë ilire dhe Olimpia nënën dhe babain e kishte ilir. Pra, shkencërisht, Aleksandri i Madh është Ilir (Shqiptar), duke patur parasysh se logjika na shpie se nëna është ajo që përcakton babain e fëmijës. Aleksandri ishte djali i ilirit Filip, nipit të Lynkestëve dhe ilires Olimpia, bijë e fisit ilir të Epirotëve. Emri i pagëzimit të Aleksandrit ishte Meriamun, një emër që zërthehet me anë të dialektit gegë të gjuhës shqipe: Mer + iam + un = MER-JAM-UN. Sot shumica e popullit shqiptar në Maqedoni ende thonë: MEJR JAM UN, që në gjuhës standarde është: MIRË JAM UNË. Aleksandri ishte mbajtës i Përkrenarës Dybrirëshe të Cjapit, që e kishte traditë dhe trashëgim nga Kryepërëndia e Olimpës të Pellazgëve – Zeusi. Më vonë këtë Përkrenare do ta mbante Piro i Epirit dhe Gjergj Kastrioti – Skënderbeu. Gjuha që u fliste Aleksandri miqve të tij ishte ilirishtja e dialektit gegë të Maqedonisë. Aleksandri greqishten e mësoi në rini nga Aristoteli. (Përgjat pushtimeve Romake kah fundi shek III -të dhe fillimi i atij të II-të (prK) përmendeshin Dasaratët dhe regjioni Dasaratia. Zbulimet tregojnë që “Fortifikata e Samuilut” ishte mbindërtuar mbi një kështjellë të mëherëshme që datonte nga shek IV (prK). Edhe studjuesi aspak i drejtë për qështjen shqiptare J.J. Wilkes në librin e tij “The Illyrians, 1992,” shkruan, “the Illyrian Enchelei, the ‘eelmen’, whose name points to a location near Lake Ohrid” (Enkelejt Ilirian, “njerëzit-njalë”, përputhet me lokacionin afër Liqenit të Ohrit). Bullgarët, rreth vitit 867 e pushtuan Ohrin, dhe Ohri ishte qendër e fortë dhe krteqytet i Imperatorisë Bullgare. Prej vitit 990 e deri në vitin 1018, Ohri ishte qendër edhe e Patriarkati Bullgar. His-



ЗЛАТНИ ПОГРЕБНИ МАСКИ ОД ТРЕБЕНИШТЕ



toria e shënoi këtë epokë si epokë bullgare, por ata aty e gjetën Ohrin dhe aty është ende. Shkrimi është kryesisht për Kështjellën e “Samuilut” dhe sipas bullgarëve kjo kështjellë u zgjodh nga Cari Samuil i Bullgarisë si kryeqytet i tij, por ajo ishte aty edhe më herët para ardhjes së sllavëve, Kështjella është edhe vetë historia e Ohrit prej shek. IV prK e deri në ditët e sotit. Edhe Kalaja e Prizrenit ishte Ilire, pastaj sllave, pastaj turke dhe sot është e Kosovës. Historia e jonë është e papërfunduar, ajo “rrëshqet” si njala. Pra “Kështjella e Samuilut” përmendet edhe nga Livy në vitin 209 prK e kjo gjatë mbretërimit të Filipit të II-të Maqedonisë.

## Kështjella e “Samuilut

“Pamja e sotme e kështjellës dhe madhësia e saj sipas të gjitha gjasave u formuan në shekullin IV psK” shkruan në shënime për këtë margaritar historik. Pra Samuil e gjeti të gatshme, 500 vjet pas. “Teknika e ndërtimit është “opus mixtum” – tulla të shtrira në tre dhe katër rreze dhe lidhura me llaç gëlqeror. Kjo kështjellë e kishte rolin e madh në mbrojtje dhe sipas shënimeve historike Theodorik Amali, Mbreti i ostrogotëve në vitin 479 në fushatën e tij okupuese të Maqedonisë dhe Epirit ishte i pasuksesshëm në robërimin e Lychnidus-it, sepse ishte i ndërtuar fortë dhe kishte burime të mbrendshme të ujit, mbrenda mureve.

Kështjella, mvarësisht prej rrethave historike ishte gjithnjë në fokus dhe shkatërrohej dhe rindërtohej në

vazhdimësi. Përndryshe hapësira sipërfaqësore ka mbetur e njëjtë që nga koha e antikuitetit.

Pas vdekjes së Samuilut më 1014, Kështjella u muarr nga Mbreti Bizantin Basili i II-të. Në shek. e 14-të gjysma e dytë e këtij shekulli pra, shënohet me një përforsim dhe rindërtim i Kështjellës në kohën e bujshme të familjes shqiptare të Andrea Gropës e cila ishte mbretëruese e regjionit të Ohrit. Pra historia nuk e ndalet e as nuk mëshifet e aq më pak të vidhet.

Edhe turqit e patën pushtuar Ohrin dhe njëstet ushtarake ishin vendosur mbrenda kështjellës, e cila në atë kohë e muarr një emër tjetër. Xheladin-Beu (1880) ndërroi, meremtoi edhe ai diçka dhe e bëri Sarajin mbrenda saj. Në vitin 1934, mbreti Aleksandër i ish Jugosllavisë, edhe ai çapuriti diçka këndej pari për ti lënë gjurmët e tija. Por origjina nuk i humbi kurrë.

Në kuadrin e hulumtimeve të vazhdueshme (2001-2002) mbrenda kështjellës janë gjetur varreza të vjetra, maskat e arta të varrosjes si dhe dorëzat e arta, që janë unike vetëm për këto anë e që datojnë që nga shek 6-5 -të para Krishtit. Pra një histori e vjedhur nga ardhacakët, të cilët nuk kanë mundësi t’ a mëshehin krejtësisht hajninë e tyre.

Për të dëshmuar se kjo anë ishte ortodokse shqiptare ja edhe dis shënime; Autorët 2. Shukarova, Aneta; Mitko B. Panov, Dragi Georgiev, Krste Bitovski, Academician Ivan Katardziev, Vanche Stojchev, Novica Veljanovski, Todor Chepeganov (2008) dhe Todor Cepreganov në librin e tyre “History of the Macedonian People” (2011) ndër tjerash shkruajnë: “Kryepeshkopi i Ohrit

, Dorotej në vitin 1466 me të gjithë priftërinjtë e tjerë u dërgua në Stamboll, sepse gjatë luftës së Skënderbeut kishin treguar antiosmanizëm”. Të njëjtën e thot edhe “Srpsko arheološko društvo (1951), Starinar, Beograd: Arheološki institut”: “Sulltani pas vdekjes së Skënderbeut, i shpërnguli një numër të madh të banorëve të Ohrit si dhe kryepeshkopin Dorotej. Vallë, Kisha e Shën Naumit a nuk ishte ortodokse shqiptare?”

**Maskat e arta të varrosjes që u gjetën në Trebenishtë -Ohër**

Kemi ende të flasim për Ohrin, qytetin e dritës. Shpesh e kam thënë se historia e jonë edhe nëse është zhdukur mbi dhe, ajo me krenarinë e saj qëndron nën te. Kemi mrekullira të ruajtura të cilat vetëm se e dokumentojnë autoktoninë tonë në këto toka. Historia e ynë është e artë, është e pruar dhe i ka bërë ballë mijërvjeçarëve; edhe pse është zhbërë, por ishte edhe e mençur dhe me dinakri qëndronte ndër dhe duke pritur momentin që të çfaqët dhe ta tregon vetvetën. Dy mijë e pasqind vjet pas, u gjetën maskat e arta të pavdekshme të engjujve për të cilët ishin bërë. Mrekullia së cilës vështirë e kemi të ia vemë çmimin u gjetë në fshatin Trebenishtë në rrugën Kërçovë-Ohër: Varrezat Antike nga mileniumi i parë i para Krishtit, të mbushura me ari, argjend dhe dhurata tjera të ndryshme të varrosjes.

Ishte 39 Shtatori 2002 kur u gjet maska e artë e pestë me rend në një kohë më pak se një shekull. (Maska e parë ishte zbuluar para 94 vjetësh). Shenjë e gjallë e një toke me pasuri të madhe arkeologjike në Europë.

“Mos i lejoni shqiptarët të gjurmojnë nëntokën, se me atë çka do të gjejnë do të iu rritet krenaria, e mandej e kemi vështirë të qeverisim me ta” - thoshin turqit në vazhdimësi. Pika arkeologjike Gorenici-Trebenishtë që daton nga shekulli 6 -të prK u zbulua për herë të parë më 1918. U gjet nekropoli, gjëja më interesante arkeologjike e Epokës së Hekurit në këto anë. U gjetën 12 varret mbretërore, e tërë dinastia e varrosur në atë vend.

Historia e maskave të arta në nekropolën e Trbenishtës (10 km nga Ohri) e kanë traditën e tyre të gjatë.

Maskat e para të arta u gjetën në kohën e sundimit bullgar të Maqedonisë (1918). Një vjet pas erdhi Mbretëria SKS, ku një pjesë e rrethinës së Ohrit me 22 fashtra iu dha (?) Shqipërisë. Në vitet 1930 – 1934, arkeologu serbe H. Vuliç, e vazhdoi zbulimin e tij me rast i gjeti edhe 6 varre tjera në të njëjtin vend, dhe e tëra që u gjat aty shkoi në Muzeumin Kombëtar të Serbisë.

Të shtojmë edhe një herë që banorët e parë regjionit të Ohrit ishin fiset Ilire të Enkelejve dhe Desaratëve

“Mos i lejoni shqiptarët të shkollohen, mos i lejoni shqiptarët të gjurmojnë nëntokën e tyre se pastaj na bëhen të rrezikshëm.”

Relievi i artë nga një varrezë në Maqedoni, shek.3 para Krishtit.